



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 30 të Ligjit për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 10. 09. 2014 pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë

VENDIM

MBI MIRATIMIN E RIDESTINIMIT DHE TRANSFERIT TË MJETEVE TË NDARJEVE BUXHETORE PËR VITIN 2014

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Ridestnimi dhe Transferi i mjeteve të ndara buxhetore për vitin 2014 siç është përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi.

Neni 2

Sipas këtij vendimi, Kryetari i Komunes pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave, mund të bartë mjetet buxhetore ashtu siç është përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi:

Neni 3

3.1.Mjetet Ridestnohen /Transferohen nga kjo ndarje buxhetore:

Mjetet nga Investimet Kapitale nga fondi burimor(10) të planifikuara në Drejtoratin, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163):

Tabela 1.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e Propozuara për Ridestnim/ Transfer
1	Asfaltimi i rrugës,,Shqipëria-Hajredin Bajrami”	89225	339,711.77	2.888,106.61	294,273.30
Totali:					294,273.30€

Mjetet nga mbetjet e projekteve në investime kapitale nga fondi burimor (10) të planifikuara në Drejtoratin, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike- 18163):

Tabela 2.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestnim/ transfer
1	Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Ribar i Madh	89227	150,000.00	113,720.46	36,279.54
2	Asfaltimi i rrugëve Brenda ne fsh. Dobraje e Madhe	89249	100,000.00	79,339.69	20,660.31
3	Asfaltimi i rrugëve Brenda në fshatin Gadime	89226	170,000.00	139,041.89	30,958.11
4	Asfaltimi i rrugëve Brenda në fshatin Qylagë	89229	100,000.00	94,624.41	5,375.59
5	Rregullimi i kanalizimit Fekal në Fshatin Llugë	89234	100,000.00	44,993.03	55,006.97
6	Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Marevc	89235	70,000.00	68,266.00	1,734.00
7	Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Ribar i Vogël	89251	50,000.00	41,880.50	8,119.50
8	Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Kojskë	89233	100,000.00	65,966.66	34,033.34
Totali:					192,167.36€

Mjetet nga Investimet Kapitale nga fondi burimor (10) të planifikuara në Dejtoratin, Kulturë Rini dhe Sport. Kodi i Programit - 85003.

Tabela 3.

Nr	Kodi i	Planifikimi	Vlera e	Mjetet e
----	--------	-------------	---------	----------

	Emërtimi i projektit	projektit		kontratës	propozuara për ridestinin/transfer
1	Ndërtimi i Sallës Sportive pranë shkollës fillore në fshatin Dobraj e Madhe	90652	151,000.00	135,776.25	15,223.75
	Totali:				15,223.75€

Mjetet nga Investimet Kapitale nga fondi burimor(21) të planifikuara në **Drejtëtoratin, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163):**

Tabela 4.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestinin/transfer
1	Asfaltimi i rrugës, Shqipëria-Hajredin Bajrami	89225	95,628.00	2.888,106.61	95,628.00
2	Rregullimi i stacionit të autobusëve në Lipjan	89253	50,000.00	-	50,000.00
3	Eliminimi i Deponive të Egra	89246	50,000.00	-	50,000.00
	Totali:				195,628.00€

Mjetet nga Investimet Kapitale nga fondi burimor(22) të planifikuara në **Drejtëtoratin, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163):**

Tabela 5.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestinin/transfer
1	Ndërtimi i Kanalizimit Qallapek-Bujari	84489	10,000.00		10,000.00
	Totali:				10,000.00€

Totali i mjeteve të propozuara për Ridestinin/Transfer, të pasqyruara në tabelat 1,2,3,4 dhe 5 është 707,292.41€

Arësytet për mjetet e propozuara për Ridestinin/Transfer:

1. Asfaltimi i rrugës, Shqipëria-Hajredin Bajrami, Kodi i projektit 89225, nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së mjeteve. Kontrata për këtë projekt është lidhur në vitin 2013 në shumë prej 2.888,106.61€ . Ndërsa, mjetet e planifikara për këtë projekt për vitin 2013 kanë qenë në shumë prej 500,000.00€. Nga kjo shumë, në vitin 2013 Thesari ka ekzekutuar pagesa për projekte tjera në shumë prej 66,783.71€; kështu që, për projektin Asfaltimi i rrugës, Shqipëria-Hajredin Bajrami në vitin 2013 janë paguar 433,216.29€. Në buxhetin e vitit 2014 për këtë projekt janë planifikuar 450,000.00€. Nga Thesari Qendrorë janë ekzekutuar dy pagesa nga ky projekt në shumë prej 14,660.23€ si dhe 45,438.47€. Nga planifikimi buxhetore për vitin 2013 dhe vitin 2014, mund të shohim se gjithsejt fondet e planifikuara për këtë projekt janë 883,216.29€, kurse kontrata e nënshkruar është 2.888,106.61€. Diference prej 2,004,890.32€ nuk është e planifikuar të financohet në Vitin 2013 dhe 2014 dhe si rrjedhojë nuk kemi fonde të garantuara për financim. Poashtu, konsiderojmë se ky projekt shoqërohet me probleme pronësoro-juridike dhe kosoto e shpenzimeve për shpronësime mund të jetë shumë e madhe e cila pamundëson komunën të zhvillojë këtë projekt.
2. Rregullimi i stacionit të autobusëve në Lipjan propozohet të ridestinohet. Ky projekt i planifikuar për këtë vit buxhetor nuk mund të realizohet sepse Organizata jonë buxhetore ka konteste pronësoro-juridike me AKP-në rreth Stacionit të Autobusëve. Një projekt i tillë mund të realizohet vetëm atëherë kur të zgjidhen këto probleme pronësoro juridike.
3. Eliminimi i Deponive të Egra. Ky projekt është tenderuar nga organizata jonë buxhetore, mirëpo tenderimi ka qenë i pasukseshëm meqë nuk janë paraqitur kompani të licencuara për eliminimin e deponive të egra. Për ti ikur rrezikut, të pamundësisë së implementimit të këtij projekti, shuma e planifikuar për këtë projekt prej 50,000.00 € propozohet të ridestinohet.
4. Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Ribar i Madh, kodi i projektit 89227, është projekt i planifikuar për vitin 2014 në shumë prej 150,000.00€. Në vitin 2014, është lidhë kontrata në shume prej 108,632.70€, si dhe një aneks kontrat në shumë prej 5,087.76€, totali 113,720.46€. Shuma e mbetur prej 36,279.54 € propozohet të

destinohet për kryerjen e projekteve të cilat Komuna e Lipjanit i vlerëson si të domosdoshme për tu implementuar në këtë vit buxhetorë 2014.

5. Asfaltimi i rrugëve Brenda në fshatin Dobrajë e Madhe kodit i projektit 89249, është projekt i vitit 2014, shuma e planifikuar për këtë projekt ka qenë 100,000.00€, kurse kontrata është lidhur në shumë prej : 72,255.56€ kurse aneks kontrata 7,084.13€ totali 79,339.69. Shumën e mbetur prej 20,660.31€ propozohet të destinohet për kryerjen e projekteve të cilat Komuna e Lipjanit i vlerëson si të domosdoshme për tu implementuar në këtë vit buxhetor 2014.
6. Asfaltimi i rrugëve Brenda në fshatin Gadime është i planifikuar në buxhet të vitit 2014 në shumë prej 170,000.00€. Procedurat e prokurimit kanë përfunduar dhe kontrata është nënshkruar me operatorin ekonomik nga ana e Komunës në shumë prej 139,041.89€. Nga ky projekt kanë tepëruar mjete në shumë prej 30,958.11€ të cilat propozohet të destinohen për kryerjen e projekteve të cilat Komuna e Lipjanit i vlerëson si të domosdoshme për tu implementuar në këtë vit buxhetor 2014.
7. Asfaltimi i rrugëve Brenda në fshatin Qylagë është projekt i planifikuar në buxhet të vitit 2014 në shumë prej 100,000.00€. Procedurat e prokurimit kanë përfunduar dhe kontrata është nënshkruar me operatorin ekonomik nga ana e Komunës në shumë prej 86,339.69€ kurse aneks kontrata 8,284.72 totali 94,624.41. Nga ky projekt kanë tepëruar mjete në shumë prej 5,375.59€ të cilat propozohet të destinohen për kryerjen e projekteve të cilat Komuna e Lipjanit i vlerëson si të domosdoshme.
8. Projekti Rregullimi i kanalizimit Fekal në Fshatin Lluge është i planifikuar në buxhet të vitit 2014 në shumë prej 100,000.00€. Vlera e kontratës së nënshkruar për këtë projekt është 44,993.03 €. Mjetet e mbetura në shumë prej 55,006.97€ propozojmë të i ridestinojmë për kryerjen e projekteve të cilat Komuna e Lipjanit i vlerëson si të domosdoshme për tu implementuar në këtë vit buxhetore.
9. Rregullimi i kanalizimit në fshatin Marevc, kodit i projektit 89235, planifikimi ka qenë 70,000.00€ kurse kontrata është 68,266.00€ shuma e mbetur prej 1,734.00€ propozohet të shkojë në projektet që komuna i konsideron të domosdoshme.
10. Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Ribar i Vogël kodit i projektit 89251, shuma e planifikuar për këtë projekt ka qenë 50,000.00€, kurse kontrata është lidhur në shumë prej: 41,880.50€, shuma e mbetur është 8,119.50€ dhe propozohet për projekte që komuna konsideron që janë të domosdoshme.
11. Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Kojak kodit i projektit 89233, shuma e planifikuar për këtë projekt është: 100,000.00€ kurse kontrata është: 65,966.66€, shuma e mbetur prej: 34,033.34€.
12. Ndërtimi i Salles Sportive pranë shkollës fillore në Fshatin Dobrajë e Madhe është projekt i planifikuar në vitin buxhetor 2014. Shuma e planifikuar e projektit është 151,000.00€. Kontrata është nënshkruar në shumë prej 135,776.25€. Mjetet e mbetura nga ky projekt në shumë prej 15,223.75€ propozohet të transferohen për kryerjen e projekteve të cilat Komuna e Lipjanit i vlerëson si të domosdoshme për tu implementuar në këtë vit buxhetore 2014.
13. Ndërtimi i Kanalizimit Qallapek-Bujari. Planifikimi i mjeteve për këtë projekt është i pamjaftueshëm për tu realizuar. Shuma e planifikuar është 10,000.00€.

3.2 Mjetet nga pozicioni i lartëcekur në paragrafin 3.1 nga Tabelat 1, te këtij neni, Ridestinohe /Transferohen në Tabelat 6 dhe 7

Drejtoratin, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163) – Fondi Burimore 10:

Tabela 6.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestinin/transfer
1	Asfaltimi i rrugëve mbrenda në qytetin e Lipjanit	89228	100,000.00		141,175.57
2	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytet	89242	100,000.00	103,097.73	3,097.73
3	Rregullimi i trotuareve në qytetin e Lipjanit	89232	70,000.00		50,000.00
Totali:					194,273.30€

Zyra e Kryetarit -16003 – Fondi Burimorë 10:

Tabela 7.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestinin/transfer
1	Pagesa për Vendime Gjyqësore	89224	70,000.00		100,000.00
Totali:					100,000.00€

Mjetet nga **Tabela 2 dhe 3** nga mbetjet e projekteve Trasferohen/Ridestinoen në **Tabelën 8** në këto projekte:
Drejtoria, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163) – Fondi Burimore 10:

Tabela 8.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/transfer
1	Rehabilitimi i Kanalizimit në Fshatin Bujari Faza I				41,852.08
2	Asfaltimi i Rrugëve në Fshatin Torinë				92,000.00
3	Rehabilitimi i Rrjeteve të kanalizimeve në fshatrat Kraishtë, Ribar i Madh, Ribar i Vogël Poturovc, Torinë, Dobrajë e Madhe, Llugë Faza I				73,539.03
Totali:					207,391.11€

Mjetet nga **Tabela 4** Trasferohen/Ridestinoen në **Tabelën 9** në këto projekte:

Drejtoria, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163) (21)

Tabela 9.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/transfer
1	Rregullimi i trotuareve në qytetin e Lipjanit	89232	70,000.00		50,000.00€
2	Asfaltimi i rrugëve mbrenda qytetit të Lipjanit	89228	100,000.00		145,628.00
Totali:					195,628.00€

Mjetet nga **Tabela 5** Trasferohen/Ridestinoen në **Tabelën 10** :

Drejtoria, Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163) – Fondi Burimore 22:

Tabela 10.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/transfer
1	Ndërtimi i trotuareve në fshatin Gadime e Epërme dhe Gadime e Ulët	87198			10,000.00
Totali:					10,000.00

Totali i mjeteve të Ridestinuara/Transferuara është: 707,292.41 €

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëher pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit dhe do të publikohet në web faqën e Komunës.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, MAPL, kurse një kopje të ruhet në dosjet e materialit të Kuvendit.

15Nr. 400-37250

Lipjan, me 10. 09. 2014

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

